



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20770 Prot.

Lezhë, më 07.12. 2021

VENDIM

Nr. 165 Datë 02.12. 2021

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës të shtetasit A.P.Z., banor në fshatin Grykë, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", të VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Agim Pjeter Zefi, banor në fshatin Grykë, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1.Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit A. P. Z. për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga zjarri në vlerën	1965624 lekë.
a) Dëmi i shkaktuar në ndërtesë	1804624 lekë.
b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje	161000 lekë.

B.Mbështetur në VKM nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërma b e ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetës në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, gërma d në VKM-në e mësipërme të jetës sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e kompensimit të dëmit në anën ndërtimore të jetës	902312 lekë.
b) Vlera e kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje	161000 lekë.

Vlera totale 1063312 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhë t'i akordojë familjes së shtetasit Z.Agim Pjeter Zefi me Nr.ID. I61210025L ndihmën emergjente në vlerën prej 1063312 (një milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise per vitin 2021, bazuar ne VKM nr.329 dt.16.05.2012.

4. Ndhma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Z Agim Pjeter Zefi, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

